




INTERIM ADMINISTRATION OF KOSOVO  
 ADMINISTRATA E PËRKOHSHME E KOSOVËS  
 PRIVREMENA ADMINSTRACIJA KOSOVA

PROKURORIA PUBLIKE E QARKUT  
 PRIZREN  
 HEP Nr. 26/2004  
 11 Shkurt 2005  
 PP-41/04



GJYKATËS SË QARKUT PRIZREN

Në bazë të Neneve 304 dhe 305 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK), Jude Romano, Prokuror Publik Ndërkombëtar në Qarkun e Prizrenit, paraqet këtë

AKTAKUZË TË PLOTËSUAR

kundër

1 Emri dhe mbiemri:	Selim KRASNIQI
Pseudonimi:	"Çeliku"
Emri dhe mbiemri i babait	[REDACTED]
Emri i Nënës	[REDACTED]
Mbiemri i gjinisë së nënës	[REDACTED]
Etnia	Shqiptar i Kosovës
Shtetësia	Jugosllave
Datëlindja:	01 Prill 1970
Vendlindja:	Vllashkidrenovc, Malishevë / Komuna e Malishevës
Vendbanimi:	Ortakoll, Prizren
Gjendja civile:	I martuar, dy fëmijë
Profesioni	Komandant i RTG2 - TMK, Prizren, gjeneral brigade
Niveli Arsimit:	Shkolla e mesme, shkolla e lartë për ekonomi, viti i fundit
Gjendja financiare:	Mesatare

Numri i identifikimit personal: KPC ID # 00624  
 Procese të tjera penale në zhvillim: Jo  
 Dënime të mëparshme: Në paraburgim që më 16 Shkurt 2004  
 Gjendja e paraburgimit:

2 Emri dhe mbiemri: Bedri ZYBERAJ  
 Pseudonimi:  
 Emri dhe mbiemri i babait: [REDACTED] Zyberaj  
 Emri i Nënës: [REDACTED]  
 Mbiemri i gjinisë i nënës: [REDACTED] Sahitaj  
 Etnia: Shqiptar / Kosovës / Jugosllave Kosovë (UNMIK)  
 Shtetësia: Jugosllave Kosovë (UNMIK)  
 Datëlindja: 06 Maj 1963  
 Vendlindja: Gjakovë  
 Vendbanimi: Prishtinë, Lagja Lakrishte, Rr. Nr. 24, hyrja nr. 3, kati i 6-të  
 Gjendja civile: I martuar, 4 fëmijë  
 Profesioni: Oficer Protokolli, Shtabi Qendror i TMK-së në Prishtinë, Lejtant Kolonel  
 Niveli Arsimor: Magjistër në gjuhësi i shkencave filologjike  
 Gjendja financiare: E ulët  
 Numri i identifikimit personal: KPC ID # 00010  
 Procese të tjera penale në zhvillim: Jo  
 Dënime të mëparshme: Në paraburgim që më 16 Shkurt 2004  
 Gjendja e paraburgimit:

3 Emri dhe mbiemri: Xhavit ELSHANI

Joh No.: Pr 235 Hep. No. 26/2004  
 Created on 3/22/2005 8:37 AM

Path name: Salim Krasniqi et al, Amended Indictment  
 Translated by: Kastriot Myftiu

Comp. No.:  
 Page 1 of 1

mbiemri:  
Pseudonimi:  
Emri dhe mbiemri i babait ■■■■ Elshani  
Emri i Nënës ■■■■  
Mbiemri i gjinisë ■■■■  
Etnia Shqiptar / Kosovës /  
Shtetësia Jugosllave (kosova / UNMUN)  
Datëlindja: 08 Korrik 1968

Vendlindja: Piranë, komuna e Prizrenit  
Vendbanimi: I njëjtë  
Gjendja civile: I martuar, dy fëmijë  
Profesioni: Shef zjarri i TMK-së, Detashmenti i Parë i Reagimit të Shpejtë, Zona 2, Shirokë, Prizren, Kapiten

Niveli Arsimit: Shkolla fillore  
Gjendja financiare: Mesatare  
Numri i identifikimit personal: KPC ID 00566  
Procese të tjera penale në zhvillim  
Dënime të mëparshme: Jo  
Gjendja e paraburgimit: Në paraburgim që më 16 Shkurt 2004

4 Emri dhe mbiemri: Xhemajl GASHI - KÇ ANATI  
Pseudonimi: "Gjermani"  
Emri dhe mbiemri i babait  
Emri i Nënës  
Mbiemri i gjinisë  
Etnia Shqiptar i Kosovës  
Shtetësia Jugosllave  
Datëlindja: 08 Gusht 1967



Vendlindja:  
 Vendbanimi: Çupevë, Klinë  
 Gjendja familjare:  
 Profesioni: Drejtues ekipi i Ekipit të Mbrojtjes, Brigada 2 e Mbrojtjes e TMK-së, Shtabi në Prizren, Toger Personeli  
 Niveli Arsimor:  
 Gjendja financiare:  
 Numri i identifikimit personal: KPC ID # 00172  
 Procese të tjera penale në zhvillim  
 Dënime të mëparshme:  
 Gjendja e paraburgimit: Për momentin në arrati

5 Emri dhe mbiemri: Isuf GASHI<sup>1</sup>  
 Pseudonimi:  
 Emri dhe mbiemri i babait: [REDACTED] Gashi  
 Emri i Nënës:  
 Mbiemri i gjinisë i nënës: [REDACTED]  
 Etnia: Shqiptar i ~~Kosovës~~  
 Shtetësia: Jugosllave KOSOVE (UNMIK)  
 Datëlindja: 20 Prill 1946  
 Vendlindja: Fshati Drenovc, Komuna e Rahovecit  
 Vendbanimi: I njëjtë  
 Gjendja civile: I martuar, pesë (5) fëmijë  
 Profesioni: Sekretar për shoqatën e veteranëve të luftës në Komunën e Rahovecit dhe ndihmës gjyqtar në Gjykatën Komunale Rahovec  
 Niveli arsimor: Shkolla fillore  
 Gjendja financiare: I varfër

<sup>1</sup> Disa dëshmitarë e thërresin Isuf Sherif

Numri i identifikimit personal:  
 Procese të tjera penale në zhvillim  
 Dënime të mëparshme: Jo  
 Gjendja e paraburgimit: Në paraburgim që më 24 Maj 2004

6 Emri dhe mbiemri: Islam GASHI  
 Pseudonimi:  
 Emri dhe mbiemri i babait: [REDACTED] Gashi  
 Emri i Nënës:  
 Mbiemri i gjinisë i nënës: [REDACTED]  
 Etnia: Shqiptar i Kosovës  
 Shtetësia: Jugosllave  
 Datëlindja: 22 Janar 1974  
 Vendlindja: Fshati Drenovc, Komuna e Rahovecit  
 Vendbanimi: I njëjtë  
 Gjendja civile: Beqar  
 Profesion: Major në TMK  
 Niveli Arsimor: Arsimi i mesëm në matematikë  
 Gjendja financiare: I varfër  
 Numri i identifikimit personal:  
 Procese të tjera penale në zhvillim  
 Dënime të mëparshme: Jo  
 Gjendja e paraburgimit: Në paraburgim që më 24 Maj 2004

## SEPSE

## PRETENDIMET LIGJORE

1. Prokurorja Ndërkombëtare ushtron këtë Aktakuzë kundër Selim KRASNIQIT (Pseudonimi "Çeliku"), Bedri ZYBERAJT, Xhavit ELSHANIT, Xhemajl GASHIT (Pseudonimi "Gjermani"), Isuf GASHIT, dhe Islam GASHIT ("të bashkëakuzuar"), të cilët akuzohen për kryeje të krimeve të luftës, në bazë të Nenit 142 të Kodit Penal të Jugosllavisë (KPJ), lidhur me Nenet 24, 30, 22 dhe 26 të KPJ-së, kryerjen, dhënien e urdhrave, ndihmën, kryerjen me mosveprim, veprimin në bashkëfajësi me të tjerët dhe pjesëmarrjen në një ndërmarrje të përbashkët kriminale me qëllim kryerjen e krimeve të luftës. Pretendohet se të bashkëakuzuarit janë personalisht përgjegjës për arrestimin e paligjshëm, paraburgimin e paligjshëm, rrahjen, torturimin dhe vdekjen e viktimave shqiptarë të Kosovës në këtë lëndë.
2. Në të gjithë harkun kohor që përfshin kjo Aktakuzë, ekzistonte gjendja e konfliktit të brendshëm të armatosur ndërmjet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") dhe Republikës Federale të Serbisë dhe Republikës Federale të Jugosllavisë, përfshirë Ushtrinë Jugosllave (VJ), forcat e Ministrisë së Brendshme të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ), forcat e Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë dhe ushtarëve paraushtarakë serbë në territorin e Kosovës. Të dyja forcat e armatosura ishin nën komandant përgjegjëse dhe ushtronin kontroll mbi një pjesë të territorit të Kosovës, për t'u mundësuar atyre të kryenin operacione ushtarake të vazhdueshme dhe të përqëndruara.
3. Sjellja e parashikuar në Nenin 142 të KPJ-së, dhe e renditur në këtë Aktakuzë, përbën krime lufte, sepse secila prej veprave kryesore të identifikuar përbën shkelje të së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme, përfshirë Nenin 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, së drejtës ndërkombëtare zakonore, të zbatueshme në konfliktin e brendshëm të armatosur; Konventave të Hagës të vitit 1899 dhe 1907, katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe Protokollit I Shtesë të vitit 1977 të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të zbatueshme në konfliktin e brendshëm të armatosur; dhe të Protokollit II Shtesë të vitit 1977 të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të zbatueshme në konfliktin e brendshëm të armatosur.
4. Neni 142 i KPJ-së është ligji i zbatueshëm në Kosovë sipas Rregullores 1999/24 të UNMIK-ut, e cila shpall se ligji i zbatueshëm në Kosovë është ligji që ishte në fuqi në Kosovë më 22 Mars 1989. Në përputhje me kërkesat e Kushtetutës së vitit 1974 të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Neni 181, pjesë e ligjit të zbatueshëm në Kosovë, (se veprat penale dhe dënimet penale mund të bazohen vetëm në dispozitën ligjore që përkufizon veprën dhe kërcënon me dënim), Neni



142 i KPJ-së përkufizon krimet e luftës kundër popullsisë civile dhe kërcënon me dënimin për këto vepra.

5. Të gjitha viktimat e luftës të përmendura në akuzat e përfshira në këtë Aktakuzë janë pjesëtarë të mbrojtur shprehimisht të popullsisë civile, siç përcaktohet në Nenin 142 të KPJ-së, dhe në bazë të së drejtës ndërkombëtare të cekur më lart.
6. Ekziston një lidhje ndërmjet krimeve të luftës të kryera, të akuzuara me këtë Aktakuzë, dhe konfliktit të brendshëm të armatosur. Prania e konfliktit të armatosur luajti rol madhor në mundësinë e të bashkëakuzuarve për t'i kryer veprat, dhe veprimet e të bashkëakuzuarve lidheshin drejtpërdrejt me konfliktin e armatosur.
7. Aktet e të bashkëakuzuarve ndodhën gjatë një periudhe kur brenda Kosovës ishte i pranishëm konflikti i brendshëm i armatosur.
8. Të bashkëakuzuarit, si autorë të krimeve të luftës, vepruan në emër të forcave të armatosura të UÇK-së dhe ishin të lidhura ngushtësisht me to, duke i bërë ata palë në konflikt. UÇK e shpalli vetveten si ushtri e ligjshme më 15 ose 16 Maj 1998.
9. Në rast dyshimi nëse veprat e provuara të të bashkëakuzuarve përbëjnë ligjërisht krimet e luftës, Akuzat thonë Trupin Gjykyes t'i gjejë të bashkëakuzuarit fajtorë për vepra individuale materiale, dhe ruan të drejtën e përmirësimit të Aktakuzës në përputhje me këtë.

#### SFONDI FAKTIK

10. Në të gjithë harkun kohor të përfshirë në këtë Aktakuzë, në Kosovë ishte e pranishme gjendja e luftës. Të gjitha veprimet dhe mosveprimet e akuzuara ishin pjesë e një sulmi të gjerë dhe sistematik të drejtuar kundër popullsisë civile serbe dhe shqiptarëve që mendohej se ishin bashkëpunëtorë të policisë, forcave ushtarake ose administratës civile serbe.
11. Në të gjithë harkun kohor të përfshirë në këtë Aktakuzë, Selim KRASNIQIT, Bedri ZYBERAJT, Xhavit ELSHANTIT, Xhemajl GASHIT, Isuf GASHIT, dhe Islam GASHIT u kërkohet t'u përmbaheshin rregullave dhe zakoneve të luftës, përfshirë Nenin 3 të Përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, së drejtës ndërkombëtare zakonore, të zbatueshme në konfliktin e brendshëm të armatosur; Konventave të Hagës të vitit 1899 dhe 1907, katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe Protokollit I Shtesë të vitit 1977 të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të zbatueshme në konfliktin e brendshëm të armatosur; dhe të Protokollit II Shtesë të vitit 1977 të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të zbatueshme në konfliktin e brendshëm të armatosur.
12. Të gjithë të bashkëakuzuarit, me dijeni dhe me dashje, morën pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, duke patur të përbashkët qëllimin e pjesëmarrësve të tjerë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, ose duke qenë të vetëdijshëm për pasojat e

<sup>2</sup> Shih Paragrafin 69 të GJPNJ-së, Aktakuza në Lëndën Nr. IT-99-37-PT (kundër Milosheviçit dhe të tjerëve); Aktakuza në Lëndën Nr. IT-03-66-PT (kundër Limajt dhe të tjerëve).



parashikueshme të zbatimit të objektivit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Mbi këtë bazë, ata mbajnë përgjegjësi penale individuale për këto krime, krahas përgjegjësisë së tyre për planifikimin, nxitjen, dhënien e urdhrave, kryerjen ose ndryshe dhënien e ndihmës në planifikimin, përgatitjen, ekzekutimin dhe kryerjen e këtyre krimeve.

13. Të gjitha viktimat e përfshira në këtë Aktakuzë u zgjodhën në bazë të dyshimit për bashkëpunim me policinë, forcat ushtarake ose administratën civile serbe. Të dyshuarit e dinin se në kohën e veprës viktimat ishin civilë, sipas përkufizimit në Nenin 3 (1) të Konventës së Gjenevës lidhur me mbrojtjen e civilëve në kohë lufte (12 Gusht 1949), domethënë si "persona që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në luftime, përfshirë pjesëtarët e forcave të armatosura të cilët kanë ulur armët dhe ata që kanë dalë jashtë luftimit për shkak të sëmundjes, plagosjes, paraburgimit ose për ndonjë shkak tjetër."
14. Gjatë periudhës Qershor - Tetor 1998, disa pjesëtarë të UÇK-së organizuan dhe drejtuan një qendër paraburgimi ("Qendra e Paraburgimit") në Fshatin Drenovc në Zatriq, Rahovec. Ekzistonte një politikë e UÇK-së e cila rezultoi me arrestimin, marrjen në pyetje, paraburgimin, rrahjen, torturimin dhe, në disa raste, vrasjen e qytetarëve jondërluftues serbë të Kosovës dhe shqiptarë të Kosovës, të cilët dyshoheshin për bashkëpunim me autoritetet serbe. Në përgjithësi, ata u paraburgosën në kushte çnjerëzore, ku iu ishin mohuar kushtet e duhura për higjienë, ushqim, ujë dhe kujdes mjekësor. Ata iu nënshtuan rrahjeve dhe torturave.
15. Të bashkëakuzuarit, në bashkëveprim me roje dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së dhe sipas një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, arrestuan në mënyrë të paligjshme disa civilë shqiptarë të Kosovës dhe i dërguan në Qendrën e Paraburgimit ku i ndaluan, rrahën, torturuan dhe vranë në mënyrë të paligjshme. Një ndër qëllimet e kësaj qendre paraburgimi ishte të paraburgoseshin civilët shqiptarë të Kosovës të cilët dyshoheshin për bashkëpunim me autoritetet serbe, dhe t'i dënonin ata për kinse mosbesnikëri ndaj UÇK-së. Një numër viktimash u morën kundër vullnetit të tyre nga familjet e tyre dhe u sollën në Qendrën e Paraburgimit, ose u ndaluan pasi u paraqitën në Qendrën e Paraburgimit në raste të ndryshme.
16. Në këtë lëndë kemi shtatë (7) viktima kryesore. Arrestimet e paligjshme të tyre ndodhën në këto data:
- i. SH [REDACTED] SH [REDACTED] u arrestua në mënyrë të paligjshme më 2 Qershor 1998. Ai, bashkë me H [REDACTED] M [REDACTED] dhe F [REDACTED] shkuan në Shtabin e UÇK-së në Drenovc më 2 Qershor 1998. M [REDACTED] dhe H [REDACTED] u lejuan të shkonin në shtëpi nga ushtarët dhe rojet e UÇK-së, ndërsa S [REDACTED] Sh [REDACTED] u arrestua dhe ndalua në mënyrë të paligjshme.
- ii. B [REDACTED] BI [REDACTED] u arrestua në mënyrë të paligjshme më 3 Qershor 1998 nga M [REDACTED] L [REDACTED], F [REDACTED], C [REDACTED] K [REDACTED] dhe N [REDACTED] K [REDACTED], sipas urdhrave të G [REDACTED] F [REDACTED] (Pseudonimi [REDACTED], nuk jeton më), i cili në atë kohë ishte Komandant i Policisë Ushtarake të Drenovcit. Dëshmitarë në arrestimin e paligjshëm kanë qenë [REDACTED] H [REDACTED] dhe Dëshmitari B. Dëshmitari A ka parë B [REDACTED] E [REDACTED] në Qendrën e



Paraburgimit me faqe të enjtura më 5 ose 6 Qershor 1998. Po kështu, Dëshmitari A e ka parë H B në Qendrën e Paraburgimit dikur në Korrik 1998, i cili dukej shumë i zbehtë dhe rrobat i kishte gjithë gjak të terur.

iii. H u arrestua në mënyrë të paligjshme më 4 Qershor 1998 nga ushtarë të UÇK-së, njëri prej të cilëve ishte Islam Gashi. Dëshmitarët TT, N dhe T e kanë parë H K në Qendrën e Paraburgimit.

iv. H P u arrestua në mënyrë të paligjshme më 7 Qershor 1998. M Popaj e ka parë H P në Qendrën e Paraburgimit. Dëshmitari A, i cili e ka parë ai u ndalua në mënyrë të paligjshme dhe e futën në të njëjtën qeli me H P në Qendrën e Paraburgimit, e ka parë këtë të fundit dikur në Qershor 1998 të mbuluar me gjak. Edhe një dëshmitar tjetër, Dëshmitari O, e ka parë H P por këte here në qendrën e paraburgimit në Malishovë.

v. M F u arrestua në mënyrë të paligjshme më 10 Qershor 1998 nga 3 ushtarë të UÇK-së me uniforma të zeza, dy prej të cilëve ishin Agron Krasniqi dhe Zaim E. Ata e morën atë nga oborri i shtëpisë së vet. Ky rrëmbim është kqyrur nga Dëshmitarët P dhe I. Dëshmitari X e ka parë M R teksa po e rrihnin në Qendrën e Paraburgimit.

vi. T u arrestua në mënyrë të paligjshme më 2 Korrik 1998 nga 4 ushtarë të UÇK-së që ruanin në një postëbllok në rrugët në Drenovc dhe Pataqan, njëri prej të cilëve ishte Xhavit Elshani. H T ishte me Dëshmitarin F kur e ndaluan në postëbllokun në fjalë. Një nip i H T e vizitoi atë në Qendrën e Paraburgimit dhe ushtarët i thanë: "Ne po e marrim në pyetje dhe atë duhet të vijë ta marrë vëllai i tij Z jo ju djelmosha."

vii. A B u arrestua në mënyrë të paligjshme më 13 Korrik 1998 nga 7 Ushtarë të UÇK-së në shtëpinë e tij, të cilët u thanë familjarëve të A se ata vetëm do t'i bënin A disa pyetje dhe ai do të lirohej menjëherë. Kjo është kqyrur nga Dëshmitari K. Kjo ishte hera e fundit që Dëshmitari K e ka parë A E.

### SHPJEGIMI I ARSYEVE PËR USHTRIMIN E AKTAKUZËS (Sipas Nenit 305 (1)(5), KPPPK)

17. Ndërmjet Qershorit 1998 dhe Tetorit 1998, pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) organizuan dhe drejtuan një qendër paraburgimit në Fshatin Drenovc në Zatriq, Rahovec ("Qendra e Paraburgimit"). Ekzistonte një politikë e UÇK-së e cila rezultoi me arrestimin, marrjen në pyetje, paraburgimin, rrahjen, torturimin dhe, në disa raste, vrasjen e qytetarëve jondërluftues serbë të Kosovës dhe shqiptarë të Kosovës, të cilët dyshoheshin për bashkëpunim me autoritetet serbe. UÇK ngriti Qendrën e Paraburgimit në të cilën u mbajtën në "izolim" ata që dyshoheshin për këtë gjë. Një numër viktimash u morën kundër vullnetit të tyre nga familjet e tyre dhe u sollën në Qendrën e Paraburgimit, ose u ndaluan pasi u paraqitën në Qendrën e Paraburgimit në raste të ndryshme.



18. Një numër dëshmitarësh deponuan se viktimat e mëposhtme u arrestuan ose u rrëmbyen, u dërguan në Qendrën e Paraburgimit në Qershor-Korrik 1998, dhe që nga ajo kohë figurojnë të zhdukur:

i. SH [REDACTED] SH [REDACTED]	(I zhdukur, mendohet i vdekur)
ii. B [REDACTED] B [REDACTED]	(I zhdukur, mendohet i vdekur)
iii. H [REDACTED] K [REDACTED]	(I zhdukur, mendohet i vdekur)
iv. H [REDACTED] P [REDACTED]	(I zhdukur, mendohet i vdekur)
v. M [REDACTED] RR [REDACTED]	(I zhdukur, mendohet i vdekur)
vi. H [REDACTED] T [REDACTED]	(I zhdukur, mendohet i vdekur)
vii. A [REDACTED] B [REDACTED]	(I zhdukur, mendohet i vdekur)

19. Më 2 Qershor 1998, SH [REDACTED] SH [REDACTED], bashkë me H [REDACTED] M [REDACTED] dhe P [REDACTED] H [REDACTED], shkuan në Shtabin e UÇK-së në Drenovë me automjetin e SH [REDACTED] SH [REDACTED]. SH [REDACTED] u ndalua nga ushtarët e UÇK-së ndërsa H [REDACTED] M [REDACTED] dhe P [REDACTED] H [REDACTED] u lejuan të shkojnë në shtëpi. Më 3 ose 4 Qershor 1998, Dëshmitari C, i shoqëruar nga H [REDACTED] M [REDACTED] shkoi në Qendrën e Paraburgimit që të kërkonte SH [REDACTED] SH [REDACTED]. Ata nuk u lejuan ta takonte. Në vizitën e dytë të tij, 3 ditë pas vizitës së parë të tij, Dëshmitari C përsëri nuk arriti ta takonte viktimën. Megjithatë, dikush i tha në shtab se "Shohani nuk është më këtu, ai është në Drenicë." Dëshmitari C vërejti automjetin e SH [REDACTED] të parkuar jashtë shtabit. Dëshmitari C nuk e ka parë kurrë më SH [REDACTED] pas datës 2 Qershor 1998.

20. H [REDACTED] M [REDACTED] e njoftoi Dëshmitarin H se SH [REDACTED] SH [REDACTED] ishte paraburgosur në Qendrën e Paraburgimit. Po kështu, M [REDACTED] tregoi Dëshmitarit H se ai kishte parë një numër ushtarësh të UÇK-së atje, ndër ta, të bashkëakuzuarit Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj dhe Isuf Sherifi (Isuf Gashi). Dëshmitari H takoi Isuf Gashin në Rahovec, i cili i tha dëshmitarit se rreth 38 të burgosur nga Drenovci, përfshirë SH [REDACTED] SH [REDACTED], ishin dërguar në Malishevë më 20 Qershor 1998.

21. Dëshmitari A dëshmoi se, më 4 Qershor 1998, ai ishte në rrugë për në Qendrën e Paraburgimit, në kërkim të B [REDACTED] B [REDACTED], kur u ndalua në rrugë nga disa ushtarë të UÇK-së, të cilët i kërkuan dokumentin e identifikimit. Një ushtar i UÇK-së e shpuri dokumentin e tij të identifikimit në shtab dhe pas kësaj mbërritën 3 ushtarë të UÇK-së. Ata ishin Çeliku, Gjermani dhe I [REDACTED] SH [REDACTED]. Dëshmitari A u dërgua në shtab dhe atje u rrah nga Çeliku dhe Gjermani, me grushte dhe shqelma, dhe nga Islami i cili kishte përdorur një shkop me tel të qarkuar rreth tij. Ditën e dytë a të tretë të ndalimit të paligjshëm të tij, Dëshmitari A u nxorr nga burgu nga dy (2) policë ushtarakë të UÇK-së, të veshur me uniforma të zeza. Pas rreth 100 metrash, Dëshmitari A vërejti B [REDACTED] B [REDACTED], SH [REDACTED] SH [REDACTED] dhe njëfarë H [REDACTED] nga fshati Deju, duke dalë nga një derë tjetër që u hap nga rojet e UÇK-së. Rojet i shoqëruan lart një kodre ku kishte puse dhe u thanë se mund të lanin fytyrën po të dëshironin. Dëshmitari A vuri re se faqja e B [REDACTED] B [REDACTED] ishte e gjitha e enjtur, ndërsa SH [REDACTED] SH [REDACTED] dhe H [REDACTED] ishin gjithë gjak. Tridhjetë minuta më pas, ata i sollën në qemte e tyre në burg. Ditën e tretë, Dëshmitarin A e liruan.



22. Tre (3) ditë pas lirimit të Dëshmitarit A, bashkëshortja e tij i tha të shkonte në Radostë (komuna e Rahovecit). Rrugës për në Radostë, atë e ndaluan dy (2) ushtarë të rinj të UÇK-së, të cilët i kërkuan dokumentin e identifikimit. Atij i thanë se dokumentin tij të identifikimit duhej ta dërgonin në shtab për të mësuar nëse mund ta lejonin të shkonte në Radostë. Pas kësaj, ushtari i UÇK-së që i kishte marrë dokumentin e identifikimit, u kthye me tre (3) ushtarë të tjerë të UÇK-së dhe i tha se ai ishte parë duke u valëvitur kapelen serbëve. Dëshmitari A u arrestua në mënyrë të paligjshme për herë të dytë dhe u soll në Qendrën e Paraburgimit ku kishte ndenjur në të njëjtën dhomë me H [redacted] E [redacted], të cilin e njohte për një kohë të gjatë. Ai vuri re se H [redacted] P [redacted] ishte i mbuluar në gjak. Ditën tjetër, në dhomën e tyre sollën Sh [redacted] Sh [redacted], gjithashtu të mbuluar në gjak. Më pas, tre (3) ushtarë të UÇK-së të veshur me uniforma të zeza, hynë në dhomën e tyre dhe filluan të rrahin Sh [redacted] Sh [redacted] Pasi e rrahën keq Sh [redacted], po këta ushtarë të UÇK-së rrahën Dëshmitarin A. I cili kujton qartë se ka parë gjakun e tij të spërkatet në tavan pasi e kishte shqelmuar njëri prej ushtarëve.
23. Më 3 Qershor 1998, E [redacted] BERISHA u arrestua në mënyrë të paligjshme nga shtëpia e axhës së tij H [redacted] në fshatin Ratkoc (Komuna e Rahovecit) nga ushtarët e UÇK-së M [redacted] L [redacted] R [redacted] Q [redacted] K [redacted] dhe N [redacted] K [redacted], sipas urdhrave të G [redacted] P [redacted] (Pseudonimi [redacted], tani nuk jeton më), i cili ishte aso kohe Komandant i Policisë Ushtarake në Fshatin Drenovc. Në arrestimin e paligjshëm ka qenë i pranishëm Is [redacted] H [redacted] dhe Dëshmitari B. Siç përshkruhet në paragrafin 21 më lart, Dëshmitari A e vërejtë B [redacted] B [redacted] me faqe të enjtura në Qendrën e Paraburgimit më 5 ose 6 Qershor 1998. Kjo ishte hera e fundit që Dëshmitari A e ka parë E [redacted] E [redacted].
24. Po kështu, një dëshmitar tjetër, Dëshmitari B, e ka parë E [redacted] B [redacted] me pamje shumë të zbehtë dhe me rrobat gjithë gjak, në Qendrën e Paraburgimit dikur në Korrik 1998. Dëshmitari B i dha B [redacted] B [redacted] rroba për t'u ndërruar. Rrobat me gjak të [redacted] u morën nga Dëshmitari B, i cili ia dorëzoi ato hetuesve të Policisë Ndërkombëtare për ekzaminim të ADN-së. Dëshmitari B dëshmoi para Gjyqtarit Hetues se e kishte parë Bedri Zyberajn disa herë në Qendrën e Paraburgimit gjatë periudhës Qershor-Korrik 1998, kur dëshmitari u përpoq të vizitonte Bedri B [redacted]. Kjo ishte hera e fundit që Dëshmitari B e ka parë B [redacted] B [redacted].
25. Më 4 Qershor 1998, H [redacted] K [redacted] u mor nga shtëpia e tij nga ushtarët e UÇK-së Agron Krasniqi, Zaim Bajraktari, Islam Gashi dhe djali i axhës i Islam Gashit. Të nesërmen, Dëshmitarët TT, N dhe T shkuan në Qendrën e paraburgimit në kërkim të H [redacted] K [redacted] dhe arritën të bisedojnë me Isuf Gashin, pastaj me Selim Krasniqin, i cili u tha të shkojnë tek Bedri Zyberaj. Megjithatë të tre (3) të bashkëakuzuarit nuk pranuan të kishin dijeni për paraburgimin e H [redacted] K [redacted] Dëshmitarët e panë viktimën disa javë pas arrestimit të paligjshëm të tij në një dhomë në Qendrën e Paraburgimit ku ishin të pranishëm një numër ushtarësh të UÇK-së, ndërmjet tyre edhe Selim Krasniqi dhe Islam Gashi.
26. Dëshmitari TT kujtoi që, kur shkoi dhe bisedoi me Bedri Zyberajn, sipas sugjerimit të Selim Krasniqit, Bedri Zyberaj u tha atyre se duhej të flisnin me Selim Krasniqin, "sepse kjo është kompetencë e tij. Ai është komandant i policisë." Dëshmitari TT deklaroi se Bedri Zyberaj ishte "komisar politik" ndërsa Selim Krasniqi ishte



Komandant i Policisë Ushtarake, i cili e mori këtë post nga G. P. pasiqë ky i fundit u vra më 18 Korrik 1998.

27. Dëshmitari N vërtetoi deklaratat e Dëshmitarit TT. Më tej ai deklaroi se, kur më në fund e panë viktimën H. K. rreth pesë (5) javë pas arrestimit të paligjshëm të tij, ai ishte në gjendje shumë të rëndë. H. mbante veshur të njëjtat rroba që kishte veshur kur ishte arrestuar në mënyrë të paligjshme. C. P., "D.", i tha Dëshmitarit N se ata ishin personat e parë që lejoneshin ta vizitonin të paraburgosurin. Dëshmitarët TT, N dhe T e panë H. K. për herë të fundit pikërisht në Qendrën e Paraburgimit.
28. Më 7 Qershor 1998, H. P. u arrestua në mënyrë të paligjshme dhe u paraburgos në Qendrën e Paraburgimit. Një ditë para arrestimit të paligjshëm të tij, djali i tij, M. P., shkoi në Qendrën e Paraburgimit me H. D. për të mësuar nëse emrat e tyre ishin në "listën e zezë". M. P. u paraburgos nga ushtarët e UÇK-së. Ushtarët e UÇK-së i thanë H. D. i thoshte H. P. P. të shkonte në Qendrën e Paraburgimit, me qëllim që të mund të lirohej djali i tij, M. P. H. P. shkoi në Qendrën e Paraburgimit ku u paraburgos në mënyrë të paligjshme, ndërsa djalin e tij e liruan.
29. Më 16 Qershor 1998, Dëshmitari Z dhe H. D. shkuan në Qendrën e Paraburgimit për të vizituar H. P. Ai arriti të ishte me Z. B. i cili u tha të shkojnë në Shtabin e UÇK-së dhe të kërkojnë Bedri Zyberajn. Bedri Zyberaj u tha atyre të shkojnë tek policia ushtarake dhe të kërkojnë "Rrezikun" (pseudonimi i C. P.). Ishte H. P. ai që i vërtetoi Dëshmitarit Z se H. P. ishte nën mbajtjen e tyre. Më tej P. i tha Dëshmitarit Z se, nëse mund të sillte atyre N. P., ata do ta lironin H. P. Dëshmitari Z nuk e pranoi propozimin e P.
30. Më pas, Dëshmitari Z dhe H. D. shkuan përsëri në Qendrën e Paraburgimit dhe takuan C. P., Selim Krasniqin dhe një polic tjetër ushtarak. Me ta foli Selim Krasniqi. Dëshmitari Z i tha Selim Krasniqit se nuk mundi ta sillte N. P. siç e kishte urdhëruar Rreziku. Selim Krasniqi u përgjigj: "Ky kusht qëndron dhe po ta sjellësh atë person, mund të marrësh Hidajn."
31. M. P. arriti të vizitonte dhe të takonte Hidajn në një dhomë në Qendrën e Paraburgimit. Hidaj i dha protezën e dhëmbëve M. për ta ndrequr. Pas takimit të shkurtër të tyre, M. doli nga dhoma dhe vërejti dhe dëgjoji Bedri Zyberajn duke thënë: *Nuk do ta kisha lejuar Hidajn t'i shihte ata, por do t'i lejoja ata të shihnin Hidajn.* Tre (3) ditë më pas, Dëshmitari Z dhe H. shkuan përsëri në Qendrën e Paraburgimit për të kthyer protezën, por u njoftuan se Hidaj ishte dërguar në Malishevë kur policia serbe kishte bombarduar Drenovcin.
32. Dëshmitari O dëshmoi se ishte arrestuar në mënyrë të paligjshme në Korrik 1998 dhe ishte paraburgosur në mënyrë të paligjshme në një ndërtesë shumë të madhe në Malishevë, ku e kishin rrahur në mënyrë të përsëritur derisa kishte humbur ndjenjat. Kur kishte ardhur në vete, aty ndodheshin tre (3) të burgosur të tjerë, të cilët ishin në gjendje shumë kritike. Ata ishin F. P. njëfarë H. K. Këta të burgosur i treguan se ishin nga Drenovci dhe se i kishin rrahur shumë herë.



33. Më 10 Qershor 1998, M. [REDACTED] RR [REDACTED] u mor nga jashtë shtëpisë së tij nga tre (3) persona të veshur me uniforma të zeza, dy (2) prej të cilëve ishin identifikuar si Agron Krasniqi dhe Zaim Bajraktari. Të nesërmen, Dëshmitari P dhe Dëshmitari I shkuan në shkollën në Fshatin Drenovc ku panë Zaim Bajraktarin. Kur u përballën me Zaim Bajraktarin, ky i fundit u tha se Muratin e kishin kyçur në bodrum dhe se, nëse donin të dinin më shumë për M. [REDACTED] ata duhej të flisnin me Bedri Zyberajn.
34. Gjatë vizitave të tyre në Qendrën e Paraburgimit, Dëshmitari P dhe Dëshmitari I vërejtën Islam Gashin, Isuf Gashin, Agron Krasniqin dhe Zaim Bajraktarin në Qendrën e Paraburgimit, ndërsa Bedri Zyberaj u vërejt në një zyrë në shtabin e UÇK-së të vendosur në ndërtesën e kooperativës bujqësore në Fshatin Drenovc. Më tej, Dëshmitari P dëshmoi se, gjatë njërës prej vizitave të tyre në Qendrën e Paraburgimit, ai dëgjoi piskama njerëzish, të cilat vinin nga bodrumi që kishte dyer mendikë dhe drithë me grila celiku.
35. Më 2 Korrik 1998, H. [REDACTED] T. [REDACTED] dhe Dëshmitari F po shkonin në rrugë për të marrë një nuse. Në rrugët Drenovc dhe Paragan, ata u ndaluan në një pikë kontrolli të UÇK-së, të ruajtur nga katër (4) ushtarë të armatosur të UÇK-së, njëri prej të cilëve ishte Xhavit Elshani. Ata morën dokumentet e tyre të identifikimit dhe u dërguan nga ushtari në vreshta. Më pas njëri prej ushtarëve të UÇK-së u kthye dhe pyeti kush ishte [REDACTED] T. [REDACTED] H. [REDACTED] identifikoi vetveten dhe pas tre (3) orësh mbërriti një veturë "Lada Caravan" dhe ata e morën H. [REDACTED] T. [REDACTED] Ushtarët e UÇK-së i thanë Dëshmitarit F se ai mund ta mernte H. [REDACTED] të nesërmen në orën 8:00 të mëngjesit. Megjithatë, Dëshmitari F nuk u kthye nga frika.
36. Një nip i H. [REDACTED] T. [REDACTED] u përpoq ta takonte, por ushtarët e UÇK-së i thanë nipit se ende po e merrnin në pyetje H. [REDACTED] dhe atë duhet të vijë ta marrë vëllai i tij Z. [REDACTED]
37. Më 13 Korrik 1998, [REDACTED] u rrëmbye në shtëpinë e tij nga shtatë (7) Ushtarë të UÇK-së, të cilët i thanë familjes së A. [REDACTED] se vetëm do t'i bënin disa pyetje dhe do ta lironin më vonë. Meqenëse A. [REDACTED] nuk u kthye më, Dëshmitari K shkoi në Drenovc ta kërkonte. Atje ai takoi Bedri Zyberajn, i cili dëgjoi se ishte "komisari" politik përgjegjës për shtabin e UÇK-së. Bedri Zyberaj i tha atij të shkonte në policinë e ndodhur në ndërtesën e shkollës dhe të kërkonte "Çeliku".
38. Në ndërtesën e shkollës, Dëshmitari K takoi një ushtar të UÇK-së me emrin I. [REDACTED] B. [REDACTED] i cili i tha se i kishte dërguar Avdiut ujë dhe gjëra të tjera të domosdoshme për të cilat kishte nevojë. Ndërsa po bisedonin, kishte mbërritur një person i quajtur "Çeliku". I. [REDACTED] B. [REDACTED] i tha Dëshmitarit K se "Çeliku" ishte personi kryesor përgjegjës për policinë ushtarake. Gjithashtu, I. [REDACTED] B. [REDACTED] i tregoi atij se emri i vërtetë i Çelikut është Selim Krasniqi.
39. Dëshmitari K iu afrua Selim Krasniqit dhe e pyeti për vendndodhjen e A. [REDACTED] B. [REDACTED]. Selimi i tregoi Dëshmitarit K se A. [REDACTED] nuk është në Drenovc por në Drenicë por ai (Dëshmitari K) nuk mund të shkonte atje për shkak të kushteve të



këqia të rrugës. Dëshmitari K dëshmoi se Selimi i pranoi atij se ai (Selimi) ishte përgjegjës për të paraburgosurit.

40. Në të gjithë kohën materiale për këtë Aktakuzë, të gjithë gjashtë (6) të bashkë-akuzuarit ishin oficerë dhe pjesëtarë të UÇK-së. Xhemajl "Gjermani" Gashi ishte Komandant i Shtabit të UÇK-së në fshatin Drenovc. Si Komandant i Shtabit të UÇK-së, Xhemajl "Gjermani" Gashi, duke vepruar në bashkëpunim me të bashkëakuzuarit e tij dhe në zbatim të një ndërmarrjeje të përbashkët, urdhëroi arrestimin dhe paraburgimin e të ndaluarve civilë dhe ushtroi pushtetin për të liruar të ndaluar civilë. Xhemajl "Gjermani" Gashi ishte përgjegjës personalisht dhe si epror për arrestimin dhe paraburgimin e paligjshëm të të ndaluarve civilë dhe krijimin dhe zgjatjen e kushteve çnjerëzore në të cilat u mbajtën të ndaluarit civilë. Xhemajl "Gjermani" Gashi, në bashkëveprim me të bashkëakuzuarit e tij dhe persona të tjerë të paidentifikuar, mori pjesë në marrjen në pyetje dhe torturimin e të ndaluarve civilë dhe në vrasjen e një numri të ndaluarish civilë.

41. Në të gjithë kohën materiale për këtë Aktakuzë, veçanërisht nga data 28 prill deri në gershor 1998 dhe disa kohë në korrik dhe gusht 1998, Selim Krasniqi u stacionua në Shtabin e UÇK-së në Fshatin Drenovc. Nga provat e mbledhura gjatë Hetimeve Givqësore, duket se Selim Krasniqi mbante një post të lartë ose ishte person me pushtet ose ishte në një post përgjegjës në shtabin e UÇK-së në Fshatin Drenovc dhe/ose Qendrën e Paraburgimit. Kjo tregohet si vijon:

41.1. Dëshmitari TT dëshmoi se Selim Krasniqi ishte Komandanti i Policisë Ushtarake, post të cilin e mori nga Gani Paqarizi, pasi ky i fundit u vra më 18 korrik 1998.

41.2. Dëshmitarët që shkuan në Qendrën e Paraburgimit në kërkim të viktimave, nga ushtarët e UÇK-së që ruanin kompleksin u dërguan ose tek Selim Krasniqi ose tek Bedri Zyberaj.

41.3. Pas dështimit për të takuar H [REDACTED] K [REDACTED] në Qendrën e Paraburgimit, Dëshmitarët N dhe TT u lejuan më në fund nga Selim Krasniqi të takojnë H [REDACTED]

41.4. Kur Dëshmitari K shkoi në Fshatin Drenovc për të kërkuar A [REDACTED] B [REDACTED] ai pa Bedri Zyberajn të ulur përpara një kompjuteri, dhe dy (2) ushtarë të UÇK-së pranë tij, brenda një shtëpie të vogël që i përkiste kooperativës së vreshtave. Bedri Zyberaj e dërgoi atë tek Selim Krasniqi.

41.5. Kur Dëshmitari TT shkoi në Qendrën e Paraburgimit për të kërkuar H [REDACTED] K [REDACTED] Selim Krasniqi e dërgoi tek Bedri Zyberaj. Nga ana tjetër, Bedri e dërgoi përsëri tek Selimi duke thënë: "Kjo është kompetencë e tij. Ai është komandant i policisë." Më tej, kur Dëshmitari TT pati një debat me zë të lartë me Agron Krasniqin gjatë njëres prej vizitave të tij, Selimi iu afrua atyre dhe e urdhëroi Agronin: "Ti shko kryej punën tënde."



41.6. Në Korrik 1998, Dëshmitari U u mor në pyetje katër (4) orë nga Selim Krasniqi. Selimi urdhëroi Agron Krasniqin dhe Zaim Bajraktarin ta rrihnin atë në një dhomë tjetër "ose tregojini atij si duhet të jenë gjërat që tani e tutje." Më tej Dëshmitari U deklaroi se mësoi nga disa ushtarë të UÇK-së se Selim Krasniqi ishte shef i zyrës.

42. Në disa raste, provat tregojnë për pjesëmarrjen konkrete të Selim Krasniqit në rrahjet dhe torturimin e viktimave.

42.1. Më 19 Gusht 1998, djali i Dëshmitarit W u ndalua dhe u arrestua nga policia serbe, e cila e rrahu dhe e paraburgosi për 4 orë para se ta lironte. Dy ditë më pas, djali u mor nga ushtarë të UÇK-së, të cilët e morën në pyetje lidhur me ato që ai i kishte treguar policisë serbe dhe përse e kishin liruuar. Atë e rrahën Selim Krasniqi në ndërtesën e shkollës në Fshatin Drenovc. Kur djali mbërriti në shtëpi, ai i tregoi Dëshmitarit W se ai (Dëshmitari W) duhej të shkonte në shkollë të nesërmen në orën 9:00 të mëngjesit. Dëshmitari W shkoi siç i kishte thënë i biri. Me të mbërritur në ndërtesën e shkollës, Selim Krasniqi e quajti tradhëtar dhe e akuzoi se u kishte dhënë ushqim serbëve. Selim Krasniqi e qëllloi me pëlëmbë kaq fort sa ai u rrëzua nga karrikja.

42.2. Në Maj 1998, Dëshmitari E ishte në një veturë e po shkonte në drejtim të Fshatit Drenovc, kur ata u ndaluan nga një ushtar i UÇK-së. Pas kësaj kishin ardhur Selim Krasniqi dhe Gani Paqarizi. Kur po dilnin nga vetura, Selim Krasniqi e lidhi dhe e goditi dy herë me qytën e një Kalashnikovi. Atë e dërguan në një ndërtesë prej druri, ku ai vërejti Bedri Zyberajn, pastaj e dërguan në bodrumin e një ndërtese tjetër ku ai u paraburgos në mënyrë të paligjshme për 3 ½ ditë pa ushqim dhe ujë.

43. Si person me pushtet ose me post përgjegjës, Selim Krasniqi, duke vepruar në bashkëpunim me të bashkëakuzuarit e tij dhe në zbatim të një ndërmarrjeje të përbashkët, urdhëroi arrestimin dhe paraburgimin e të ndaluarve civilë dhe ushtror pushtetin për të liruuar të ndaluar civilë. Selim Krasniqi ishte përgjegjës personalisht dhe si epror ose si person me pushtet për arrestimin dhe paraburgimin e paligjshëm të të ndaluarve civilë dhe krijimin dhe zgjatjen e kushteve çnjerëzore në të cilat u mbajtën të ndaluarit civilë. Selim Krasniqi, në bashkëveprim me të bashkëakuzuarit e tij dhe persona të tjerë të paidentifikuar, mori pjesë në marrjen në pyetje dhe torturimin e të ndaluarve civilë dhe në vrasjen e një numri të ndaluarish civilë.
44. Në të gjithë kohën materiale për këtë Aktakuzë, veçanërisht nga marsi 1998, Bedri Zyberaj ishte pjesëtar i UÇK-së dhe u stacionua në Shtabin e UÇK-së në Fshatin Drenovc. Nga provat e mbledhura gjatë Hetimeve Gjyqësore, duket se Bedri Zyberaj mbante një post të lartë ose ishte person me pushtet ose ishte në një post përgjegjës në shtabin e UÇK-së në Fshatin Drenovc dhe/ose Qendrën e Paraburgimit. Kjo tregohet si vijon:



44.1. Dëshmitarët TT, P dhe K dëshmuar se **Bedri Zyberaj** quhej *komisari politik*.

44.2. Dëshmitari Z u dërgua nga Zaim Bajraktari tek Bedri Zyberaj kur ai shkoi në Qendrën e Paraburgimit të kërkonte H [REDACTED] P [REDACTED]

44.3. Kur Dëshmitari K shkoi në Fshatin Drenovc për të kërkuar A [REDACTED] E [REDACTED] ai pa Bedri Zyberajn të ulur përpara një kompjuteri, dhe dy (2) ushtarë të UÇK-së pranë tij, brenda një shtëpie të vogël që i përkiste kooperativës së vreshtave. Bedri Zyberaj e dërgoi atë tek Selim Krasniqi.

45. Në disa raste, provat tregojnë pjesëmarrjen konkrete të **Bedri Zyberajt** në rrahjen dhe torturimin e viktimave.

45.1. Gjatë paraburgimit të paligjshëm të Dëshmitarit E në hoduan, u paraqit Bedri Zyberaj. Bedriu nxorri një armë nga brezi i tij dhe ia drejtoi Dëshmitarit E në gjoks. Isuf Gashi e nxiti Bedriun që ta qëllonte duke i thënë: "Qëlloje këtë person se është bashkëpunëtor serb dhe nuk e njoh fare." Pas asaj që u duk si një kohë pambarim nënshtrimi ndaj torturës mendore dhe ndaj terrorit të egër, Dëshmitari E u lirua përkohësisht kur Bedriu dhe Isufi u larguan nga dhoma. Por marrja e vetes nga ana e tij ishte jetëshkurtër, sepse pak caste më pas, aty brenda hynë 2 persona të cilët e rrahën me shkopinj druri duke e bërë të humbasë ndjenjat.

46. Si person me pushtet ose me post përgjegjësie, **Bedri Zyberaj**, duke vepruar në bashkëpunim me të bashkëakuzuarit e tij dhe në zbatim të një ndërmarrjeje të përbashkët, urdhëroi arrestimin dhe paraburgimin e të ndaluarve civilë dhe ushtri pushtetim për të liruar të ndaluar civilë. **Bedri Zyberaj** ishte përgjegjës personalisht dhe si epror ose si person me pushtet për arrestimin dhe paraburgimin e paligjshëm të të ndaluarve civilë dhe krijimin dhe zbatimin e kushteve çnjerëzore në të cilat u mbajtën të ndaluarit civilë. **Bedri Zyberaj**, në bashkëveprim me të bashkëakuzuarit e tij dhe persona të tjerë të paidentifikuar, mori pjesë në marrjen në pyetje dhe torturimin e të ndaluarve civilë dhe në vrasjen e një numri të ndaluarish civilë.

47. Në të gjithë kohën materiale për këtë Aktakuzë, **Isuf Gashi** ishte pjesëtar i UÇK-së në Fshatin Drenovc. Si pjesëtar i UÇK-së në Fshatin Drenovc, duke vepruar në bashkëpunim me të bashkëakuzuarit e tij dhe persona të tjerë të paidentifikuar, **Isuf Gashi** mori pjesë në arrestimin dhe paraburgimin e paligjshëm dhe në marrjen në pyetje, torturimin dhe vrasjen e të ndaluarve civilë. Ndër të tjera, **Isuf Gashi** mori pjesë në torturimin e Dëshmitarit E. **Isuf Gashi** u vërejt nga disa dëshmitarë në Qendrën e Paraburgimit.

48. Në të gjithë kohën materiale për këtë Aktakuzë, **Islam Gashi** ishte pjesëtar i policisë ushtarake të UÇK-së në Fshatin Drenovc. Si pjesëtar i policisë ushtarake të UÇK-së, duke vepruar në bashkëpunim me të bashkëakuzuarit e tij dhe persona të tjerë të paidentifikuar, **Islam Gashi** mori pjesë në arrestimin, paraburgimin e paligjshëm dhe në marrjen në pyetje, torturimin dhe vrasjen e të ndaluarve civilë duke zbatuar urdhra të paligjshëm të të bashkëakuzuarve të tij. Ndër të tjera, **Islam Gashi** ishte përgjegjës për arrestimin dhe paraburgimin e paligjshëm të H [REDACTED]



[REDACTED] Islam Gashi u vërejt nga disa dëshmitarë duke vepruar si roje në Qendrën e Paraburgimit.

49. Në të gjithë kohën materiale për këtë Aktakuzë, Xhavit Elshani ishte pjesëtar i policisë ushtarake të UCK-së në Fshatin Drenovc. Si pjesëtar i policisë ushtarake të UCK-së, duke vepruar në bashkëpunim me të bashkëakuzuarit e tij dhe persona të tjerë të paidentifikuar, Xhavit Elshani mori pjesë në arrestimin, paraburgimin e paligjshëm dhe në marrjen në pyetje, torturimin dhe vrasjen e të ndaluarve civilë. Ndër të tjerë, ai ishte përgjegjës për arrestimin dhe paraburgimin e paligjshëm të [REDACTED] [REDACTED]. Po kështu, Dëshmitari E dëshmoi se Xhavit Elshani e arrestoi në mënyrë të paligjshme, e paraburgosi dhe e torturoi, Xhavit Elshani u vërejt nga disa dëshmitarë duke vepruar si roje në Qendrën e Paraburgimit.

*Deklarata e Selim Krasniqi:*

50. Në deklaratën e tij dhënë në polici, Selim Krasniqi deklaroi se ishte kycur në UCK në fillim të majit 1997. Ai ishte në Drenovc të Zatriqit nga 28 prilli 1998 deri në qershor 1998, por qëndrimi i tij nuk ishte i vazhdueshëm. Në atë kohë, Xhem "Gjermani" Gashi ishte komandant i UCK-së në Drenovc në Zatriq, ndërsa Gani Paqarizi ishte shef i policisë ushtarake. Fillimisht shtabi i UCK-së në Drenovc ndodhej në shtëpi private por më pas u bart në një ndërtesë bujqësore të ndodhur jashtë qendrës së Drenoveit. Ai mohoi të ketë dijeni për ekzistencën e qendrës së paraburgimit në Drenovc, por deklaroi se aty kishte disa zyra ku u mbajtën disa njerëz. Këto zyra ndodheshin në ndërtesën e një shkollë rreth 500 metra larg shtabit të UCK-së. Gani Paqarizi e kishte zyrën në të njëjtën ndërtesë. Ai deklaroi se vetëm Gani Paqarizi kishte të drejtë të dërgonte njerëz në këtë ndërtesë. Ai pretendon se një herë Gani Paqarizi i kishte thënë se ai (Ganiu) kishte sjellë në ndërtesë shqiptarë kosovarë të cilët dvshohej se ishin bashkëpunëtorë të Forcave Serbe dhe se disa prej tyre ishin kapur në flagrancë.
51. Më tej Selim Krasniqi deklaroi se në tre a katër raste kur kishte shkuar tek zyra e Gani Paqarizit, ai kishte parë Ganiun duke marrë në pyetje disa ujerëz. Ai nuk i njihte njerëzit që po merreshin në pyetje dhe nuk kishte parë asgjë të pazakontë me mënyrën se si Gani Paqarizi po e zhvillonte marrjen në pyetje.
52. Po kështu, Selim Krasniqi deklaroi se ishte një ushtar i thjeshtë kur ishte në Fshatin Drenovc në Zatriq dhe se nuk kishte ndonjë detyrë, as post të caktuar. Megjithatë, ai pranoi se ishte përfshirë në disiplinimin e ushtarëve dhe se Komandant Gashi (Xhemajl "Gjermani" Gashi) ishte eprori i tij.
53. Kur u pyet për emrat konkretë të viktimave të cekura më lart, Selim Krasniqi pranoi se mbante mend emrin e Sh [REDACTED] Si [REDACTED] sepse Gani Paqarizi ia kishte përmendur këtë emër atij, megjithëse nuk i kujtohej ofarë i kishte thënë Ganiu për Si [REDACTED]. Gjithashtu ai kujton që një burrë me mbiemrin I [REDACTED] ishte marrë në pyetje nga Gani Paqarizi. Sa për H [REDACTED] K [REDACTED], ai kujton ta ketë



takuar H [REDACTED] një herë jashtë oborrit të shkollës, ku C [REDACTED] kishte një zyrë. Ai beson se edhe H [REDACTED] ishte marrë në pyetje nga C [REDACTED], sepse kjo ishte e vetmja arsye përse një person do të shkonte në zyrën e [REDACTED] Selim Krasniqi mban mend edhe emrin e M [REDACTED] R [REDACTED]. Ai kishte dëgjuar se vëllai i M [REDACTED], H [REDACTED] R [REDACTED] ishte pjesëtar i Forcave Serbe dhe ndoshta për këtë arsye M [REDACTED] ishte marrë në pyetje nga P [REDACTED]. Përsa u përket viktimave të tjera, domethënë, H [REDACTED] T [REDACTED] A [REDACTED] E [REDACTED] dhe B [REDACTED], ai mohoi të kishte dijeni apo ndonjë informatë për ta.

54. Selim Krasniqi dha të njëjtën deklaratë para Gjyqtarit Hetues. Në mbështetje të provës së tij, Selim Krasniqi paraqiti dëshmitarë të cilët dëshmuan se e kishin parë atë në Tiranë, Shqipëri, dikur në Korrik deri në Gusht 1998.

*Deklarata e Bedri Zyberajt:*

55. Në deklaratën e tij para hetuesve të policisë, Bedri Zyberaj pohoi se ishte kyçur në UÇK rreth marsit të vitit 1998, me qëllim që të ndihmonte njerëzit. Detyra kryesore e tij ishte të ndihmonte në shpërndarjen e ushqimit dhe përhapjen e informacionit. Ai pretendon se nuk ka veshur kurrë uniformë ushtarake dhe nuk kishte ndonjë gradë konkrete. Ai pranon se e ka njohur Selim Krasniqin që në qershor 1998 kur ky i fundit kishte filluar të punonte në shtabin e UÇK-së në fshatin Drenovc. Bedri Zyberaj pranoi se kishte dëgjuar për praninë e një qendre paraburgimi në Drenovc dhe se ajo ishte synuar për ushtarët e UÇK-së që silleshin keq. Megjithatë, ai pretendon se nuk ka shkuar asnjëherë atje dhe nuk e njohte komandantin apo drejtuesin e qendrës së paraburgimit. Gjatë hetimeve gjyqësore, ai zgjodhi të mos jepte deklaratë. Në vend të kësaj, ai paraqiti dëshmitarë të cilët dëshmuan lidhur me karakterin e tij, të cilët deklaruan se gjatë periudhës në fjalë Bedri Zyberaj ishte përfshirë në punë bamirësie në administrimin e një depoje ku merreshin, magazinoheshin dhe u shpërndaheshin fshatarëve ndihma humanitare.

*Deklarata e Islam Gashit:*

56. Islam Gashi dëshmoi se u kyç në UÇK më 26 Prill 1998. Ai u plagos rëndë më 27 Maj 1998, gjë që kërkoi që ai të shtrohej në spital për më shumë se një (1) muaj. Për shkak të lëndimeve të tij, ai mundi të kyçej përsëri në UÇK vetëm në Janar 1999. Po kështu, ai deklaroi se edhe babai i tij Isuf Gashi ishte plagosur rëndë më 18 Korrik 1998. Islam Gashi e mohoi që në Drenovc të kishte patur shtab të UÇK-së dhe Qendër Paraburgimi.

*Deklarata e Isuf Gashit:*

57. Isuf Gashi deklaroi se u kyç në UÇK në 1996. Detyra kryesore e tij ishte të kujdesej për furnizimin me ushqime dhe armë. Ai u plagos rëndë më 18 Korrik 1998 dhe kjo ndaloi kyçjen e tij në ndonjë veprimtari të UÇK-së, pasi ai qëndroi në Tiranë, Shqipëri, për 9 muaj për të rimarrë veten. Gjithashtu ai deklaroi se në Drenovc nuk kishte burg të UÇK-së në atë kohë, por vetëm një zyrë mbledhjesh.



58. **Xhavit Elshani** nuk u dha asnjë deklaratë hetuesve të policisë, as gjyqtarit hetues. Po kështu, ai nuk propozoi asnjë dëshmitar.
59. Xhemajl "Gjermani" Gashi u shpall person në mungesë.

**PËRSHKRIMI DHE EMËRTIMET LIGJORE TË VEPRAVE PENALE**  
(Sipas Neneve 305 (1)[3] dhe 305 (1)[4] të KPPPK-së)

60. Në përshkrimin e emërtimeve ligjore të veprave penale, çdo akuzë për krime lufte paraprihet nga citimi i një a disa prej krimeve konkrete që mund të përfshihen brenda tij dhe që do të përbënin vepra të veçanta në bazë të Kodit Penal të Kosovës, lidhur me Kodin Penal të Jugosllavisë.

**AKUZA 1**

61. Në ditët midis datave 2 Qershor 1998 dhe 13 Korrik 1998, **Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj, Xhemajl Gashi, Isuf Gashi, Islam Gashi dhe Xhavit Elshani**, duke vepruar në bashkëpunim me individë të tjerë, dhe në zbatim të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, urdhëruan dhe morën pjesë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në arrestimet dhe paraburgimin e paligjshëm të civilëve shqiptarë të Kosovës në Qendrën e Paraburgimit në Fshatin Drenovc. Ndër këta civilë të arrestuar në mënyrë të paligjshme ishin:

- i. **S** [redacted] **S** [redacted] u arrestua në mënyrë të paligjshme dhe u paraburgos në mënyrë të paligjshme më 2 Qershor 1998 në Qendrën e Paraburgimit në Fshatin Drenovc. Deri më sot ai nuk është parë më.
- ii. **B** [redacted] **B** [redacted] u arrestua në mënyrë të paligjshme dhe u paraburgos në mënyrë të paligjshme më 3 Qershor 1998 në Qendrën e Paraburgimit në Fshatin Drenovc. Deri më sot ai nuk është parë më.
- iii. **H** [redacted] **K** [redacted] u arrestua në mënyrë të paligjshme dhe u paraburgos në mënyrë të paligjshme më 4 Qershor 1998 në Qendrën e Paraburgimit në Fshatin Drenovc. Deri më sot ai nuk është parë më.
- iv. **H** [redacted] **P** [redacted] u arrestua në mënyrë të paligjshme dhe u paraburgos në mënyrë të paligjshme më 7 Qershor 1998 në Qendrën e Paraburgimit në Fshatin Drenovc. Deri më sot ai nuk është parë më.
- v. **M** [redacted] **Rru** [redacted] u arrestua në mënyrë të paligjshme dhe u paraburgos në mënyrë të paligjshme më 10 Qershor 1998 në Qendrën e Paraburgimit në Fshatin Drenovc. Deri më sot ai nuk është parë më.
- vi. **H** [redacted] **T** [redacted] u arrestua në mënyrë të paligjshme dhe u paraburgos në mënyrë të paligjshme më 2 Korrik 1998 në Qendrën e Paraburgimit në Fshatin Drenovc. Deri më sot ai nuk është parë më.

16.05.98  
06.06.98  
Ne  
- Propozim  
- ko qer  
- per denu  
Kot. 388/98  
Gj. P. P. P. P. P.  
dt. P. P. 98  
v. p. 33/22

vii. A [REDACTED] B [REDACTED] u arrestua në mënyrë të paligjshme dhe u paraburgos në mënyrë të paligjshme më 13 Korrik 1998 në Qendrën e Paraburgimit në Fshatin Drenovc. Deri më sot ai nuk është parë më.

62. Duke marrë pjesë në arrestimin dhe ndalimin e paligjshëm të civilëve shqiptarë të Kosovës, të cekur në paragrafet 61(i) deri në 61(vii) më lart, Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj, Xhemajl Gashi, Isuf Gashi, Islam Gashi dhe Xhavit Elshani shkaktuan përgjegjësi individuale për krimet e luftës të arrestimeve dhe ndalimit të paligjshëm, në shkelje të Nenit 142 të KPJ-së, lidhur me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KPJ-së.

### AKUZA 2

63. Në ditët midis datave 2 Qershor 1998 dhe 13 Korrik 1998, Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj, Xhemajl Gashi, Isuf Gashi, Islam Gashi dhe Xhavit Elshani, përderisa ishin anëtarë të UÇK-së, duke vepruar në bashkëpunim me individë të tjerë, dhe në zbatim të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale për të paraburgosur në mënyrë të paligjshme civilë shqiptarë të Kosovës, urdhëruan dhe morën pjesë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në ndërmarrjen dhe kryerjen e trajtimit çnjerëzor të civilëve shqiptarë të Kosovës të paraburgosur në mënyrë të paligjshme në Qendrën e Paraburgimit të ndodhur në Fshatin Drenovc, duke i strehuar këta të paraburgosur civilë në kushte çnjerëzore, duke i privuar nga higjiena, ushqimi dhe uji i duhur, dhe trajtimi i nevojshëm mjekësor. Trajtimi çnjerëzor i civilëve të paraburgosur shkaktoi vuajtje të mëdha ose ishte dhunim i integritetit dhe shëndetit trupor të këtyre të paraburgosurve dhe përbënte zbatim të masës së kërcënimit dhe terrorit. Ndër këta civilë që iu nënshtuan trajtimit çnjerëzor, ishin edhe të shtatë (7) viktimat e përmendura në paragrafet 61(i) deri në 61(vii) më lart.

64. Duke marrë pjesë në vendosjen dhe zbatimin e trajtimit çnjerëzor të civilëve shqiptarë të Kosovës, të cekur në paragrafet 61(i) deri në 61(vii) më lart, Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj, Xhemajl Gashi, Isuf Gashi, Islam Gashi dhe Xhavit Elshani, shkaktuan përgjegjësi personale për krimet e luftës të trajtimit çnjerëzor dhe vuajtjeve të mëdha ose dhunimit të shëndetit trupor të civilëve të paraburgosur dhe ndërmorën zbatimin e masave të kërcënimit dhe terrorit, në shkelje të Nenit 142 të Kodit Penal të Jugosllavisë (KPJ), lidhur me Nenet 22, 23, 24, 26 dhe 30 të KPJ-së.

### AKUZA 3

65. Në ditët midis datave 2 Qershor 1998 dhe 13 Korrik 1998, Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj, Xhemajl Gashi, Isuf Gashi, Islam Gashi dhe Xhavit Elshani, përderisa ishin anëtarë të UÇK-së, duke vepruar në bashkëpunim me individë të tjerë, dhe në zbatim të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, urdhëruan dhe morën pjesë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në rrahjen dhe torturimin e civilëve të paraburgosur në mënyrë të paligjshme në Qendrën e Paraburgimit të ndodhur në Fshatin Drenovc. Ndër këta civilë që iu nënshtuan rrahjeve dhe torturave ishin edhe të shtatë (7) viktimat e përmendura në paragrafet 61(i) deri në 61(vii) më lart.



66. Duke marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e civilëve shqiptarë të Kosovës, të cekur në paragrafët 61(i) deri në 61(vii) më lart, Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj, Xhemajl Gashi, Isuf Gashi, Islam Gashi dhe Xhavit Elshani shkaktuan përgjegjësi individuale për krimet e luftës të rrahjes dhe torturës dhe vuajtjeve të mëdha ose dhunimit të shëndetit trupor të të paraburgosurve civilë, dhe ndërmorën zbatimin e masave të kërcënimit dhe terrorit, në shkelje të Nenit 142 të KPJ-së, lidhur me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KPJ-së.

#### AKUZA 4

67. Në ditët midis datave 2 Qershor 1998 dhe 13 Korrik 1998, Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj, Xhemajl Gashi, Isuf Gashi, Islam Gashi dhe Xhavit Elshani, përderisa ishin anëtarë të UÇK-së, duke vepruar në bashkëpunim me individë të tjerë, dhe në zbatim të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, urdhëruan dhe morën pjesë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në vrasjet e civilëve shqiptarë të Kosovës të arrestuar dhe të paraburgosur në mënyrë të paligjshme në Qendrën e Paraburgimit në Fshatin Drenovc. Ndër këta civilë ishin edhe të shtatë (7) viktimat e përmendura në paragrafët 61(i) deri në 61(vii) më lart.
68. Duke marrë pjesë në vrasjet e civilëve shqiptarë të Kosovës, të cekur në paragrafët 61(i) deri në 61(vii) më lart, Selim Krasniqi, Bedri Zyberaj, Xhemajl Gashi, Isuf Gashi, Islam Gashi dhe Xhavit Elshani shkaktuan përgjegjësi individuale për krimet e luftës të vrasjeve dhe zbatuan masat e kërcënimit dhe terrorit, në shkelje të Neni 142 të KPJ-së, lidhur me Nenet 22, 24, 26 dhe 30 të KPJ-së.

IV

#### ARSYETIM

69. Provat e mbledhura gjatë hetimeve policore dhe hetimeve gjyqësore mbështesin akuzat se të bashkëakuzuarit shkelën ligjin në mënyrën e përshkruar më lart. Provat e mbledhura deri më sot nuk mbështesin ndonjë mbrojtje ligjore ndaj akuzave.
70. Qëndrimi i të nënshkruarit është se mbrojtjet e bëra nga të bashkëakuzuarit në paragrafët 50 deri në 58, që në përgjithësi janë mohime, nuk mund t'i hedhin poshtë dëshmitë dhe identifikimin e bërë nga dëshmitarët.

#### PROPOZIM PËR SHQYRTIMIN KRYESOR (Sipas Nenit 305 (1)[6] të KPPPK-së)

Prokurori Publik Ndërkombëtar propozon caktimin dhe mbajtjen e shqyrtimit kryesor për këtë lëndë.

#### REKOMANDIM LIDHUR ME PROVAT DHË DËSHMITARËT (Sipas Nenit 305 (1)[7] të KPPPK-së)

Prokurori Publik Ndërkombëtar kërkon:

A. Që të thirren për të marrë pjesë këta persona:

Prokurori Publik Ndërkombëtar e Prizrenit  
Të bashkëakuzuarit  
Mbrojtësit e të bashkëakuzuarve

Si dhe këta dëshmitarë:

1. Dëshmitari A c/o Hetues i CCIU-t Amrendra Sengar
2. Dëshmitari B -//-
3. Dëshmitari C -//-
4. Dëshmitari E -//-
5. Dëshmitari F -//-
6. Dëshmitari H -//-
7. Dëshmitari I -//-
8. Dëshmitari K -//-
9. Dëshmitari N -//-
10. Dëshmitari O -//-
11. Dëshmitari P -//-
12. Dëshmitari U -//-
13. Dëshmitari W -//-
14. Dëshmitari X -//-
15. Dëshmitari Z -//-
16. Dëshmitari TT -//-
17. R. [REDACTED] E [REDACTED]
18. R. [REDACTED] E [REDACTED]
19. S. [REDACTED] K [REDACTED]
20. M. [REDACTED] S [REDACTED]

B. Që gjykata të lexojë dhe të shqyrtojë këto dokumente:

1. Proces-verbalin e dëshmisë së policit të UNMIK-ut H [REDACTED] C [REDACTED] [REDACTED] i cili tashmë është larguar nga Misioni;
2. Proces-verbalin e dëshmisë së [REDACTED] [REDACTED] [REDACTED] V [REDACTED], i cili gjithashtu është larguar nga Misioni;
3. Rezultatet e Raportit të ekspertit mjekoligjor mbi analizën e ADN-së të rrobave të përgjakura të B [REDACTED] E [REDACTED]
4. Raporti "Siç është parë dhe treguar", Vëllimi 1, botuar nga OSBE.

C. Që gjykata të rishikojë dhe shqyrtojë këto eksponate fizike:

1. fotorreshtimin e të dyshuarve (14 foto, eksponati nr. 3)
2. fotorreshtimin numër një (të dyshuarit, 31 foto, eksponati nr. 4)
3. fotot e strukturave (33 foto, eksponati nr. 5)



4. fotorreshtimin e viktimave (9 foto, eksponati nr. 7)
5. fotorreshtimin e të dyshuarve (33 foto, Eksponati Nr. 6)

D. I nënshkruari Prokuror Ndërkombëtar rezervon të drejtën që gjatë shqyrtimit kryesor të propozojë çështje të tjera të cilat i mendon të përshtatshme.

### KËRKESA PËR PARABURGIMIN E TË PANDEHURVE (Sipas Nenit 281 të KPPPK-së)

Në bazë të Nenit 281 të KPPPK-së, PARABURGIMI I TË GJASHTË TË AKUZUARVE propozohet për këto arsye.

Akuza thekson se, në bazë të Nenit 281, Paragrafi 1, Pika 2 (i), të KPPPK-së, ekziston rreziku serioz se, po të lirohen, të dyshuarit kanë mundësinë nëpërmjet lidhjeve të tyre me ish pjesëtarë të UÇK-së, të largohen nga Kosova, nëpërmjet rrugëve të ligjshme ose të paligjshme kufitare, duke patur parasysh mbështetjen e gjerë publike për kauzën e tyre, dhe trazirat e fundit në mars 2004, duke treguar mbështetje të vazhdueshme të pacilësuar për veteranët e luftës.

Po kështu, Akuzat parashtron se, në bazë të Nenit 281, Paragrafi 1, Pika 2 (ii), të KPPPK-së, ekziston rreziku serioz se Hetimet do të pengoheshin në rast se të dyshuarit lirohen. Provat tregojnë se të dyshuarit dhe/ose bashkëpunëtorët e tyre janë të përgatitur të paralajmërojnë dhe/ose kërcënojnë të tjerët që të mos u përgjigjen pyetjeve lidhur me veprat. Në një incident veçanërisht shqetësues, në ditën pas arrestimit të katër prej të bashkëakuzuarve, shtëpia e një të afërmi të një viktime në këtë lëndë u bë objekt sulmi me një mjet plasës. Motive të tjera të njohura për këtë sulm nuk ka, ndaj ai shkakton dyshimin e arsyeshëm se lidhjet me dhënien e dëshmisë nga dëshmitari në këtë lëndë. Për më tepër, siç del në proces-verbalin e dëshmisë së Dëshmitarit B, Dëshmitarët A dhe B i raportuan Gjyqtarit Hetues se, pas deponimit të tyre, 3 persona të armatosur, dy prej të cilëve kishin veshur maska në kokë, i përcollën ata deri në shtëpinë e tyre. Prandaj, taslmë ekziston rreziku i kërcënimit të dëshmitareve, gjë që, sipas parashtrimit të Akuzës, do të rritej së tepërmi në rast se të dyshuarit do të lireshin të lirë.

Duke patur parasysh natyrën e egër dhe gjakftohtë të akteve kriminale të kryera nga të akuzuarit dhe numrin e viktimave që ende figurojnë të zhdukur dhe paramendohen të vdekur, ekziston rreziku serioz se, po të liroheshin, ata do të kryenin vepra të tjera dhune kundër dëshmitarëve që planifikohet të dëshmojnë në shqyrtimin gjyqësor. Fakti që të akuzuarit janë të aftë të përdorin dhunën ose të kërcënojnë për përdorimin e saj, është treguar nga paraburgimi, torturimi dhe rrahja e viktimave të përfshira në pretendimet e ngritura kundër të akuzuarve.

Prokurori Publik Ndërkombëtar beson se masat e tjera të parashikuara në Nenin 268, Paragrafi 1, të KPPPK-së do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e të akuzuarve, për të parandaluar përsëritjen e veprave dhe për të garantuar kryerjen me sukses të procedurës.

Prandaj, Prokurori Publik Ndërkombëtar propozon që të gjithë të pandehurit të mbeten në paraburgim deri në përfundim të të gjithë procedurës penale.

Mbështetur në sa më lart, për Akuzën është e qartë se veprimet e të bashkëakuzuarve përfshijnë të gjitha cilësimet themelore të veprave penale që u vihen në barrë, prandaj kjo Aktakuzë është e arsyetuar, e vërtetuar dhe e mbështetur në ligj.

Jude Romano  
Prokuror Publik Ndërkombëtar